

Kisha e Shën Kollit, itinerari i ri i "Rrugëve të Besimit"



Kanë përfunduar punimet e fazës së parë për restaurimin e Kishës së Shën Kollit në Mesopotam, Sarandë.

Kisha e Shën Kollit është një ndër kishat më të mëdha dhe me vlera të rralla të periudhës bizantine.

Ajo shquhet për arkitekturë unike, për dekoracionin e saj me tulla, për relievet skulpturalë në muret e jashtme të fasadave, si dhe për vlerat e larta artistike.

Gjatë vitit 2019, do kryhen nga specialistët punimet në brendësi si pastrimi nga mbivëniet për të zbuluar afresket e mbetura, ndërhyrje në dysheme për të vlerësuar pjesët e vjetra, si dhe hapja e dy dyerve në jug, një dritareje në veri dhe restaurimi i dy nikeve në pjesën e narteksit (njëra nga të cilat shërbente deri sot si

hyrja për në kishë).

Krahas tyre dhe një sërë ndërhyrjesh në muret rrethues të Manastirit dhe hyrjet e vjetra në të.

Tashmë kjo kishë është një tjetër itinerar i "Rrugëve të Besimit" e cila i shtohet listës së turizmit religjioz ku turistët vendas dhe të huaj kanë mundësi të shohin nga afër historinë e ndërthurur me bukuritë e peizazhit dhe kultit.

/ATSH/



